


# **GRUAJA DHE HAPËSIRA PUBLIKE**

## **Siguria në hapësirat publike**



**RAPORT I VIZIONIMIT TË PUNËTORISË "GRUAJA DHE HAPËSIRA  
PUBLIKE - SIGURIA NË HAPËSIRAT PUBLIKE"**

**SHTATOR, 2017**



# **GRUAJA DHE HAPËSIRA PUBLIKE**

## **Siguria në hapësirat publike**

### **RAPORT I VIZIONIMIT TË PUNËTORISË "GRUAJA DHE HAPËSRA PUBLIKE - SIGURIA NË HAPËSIRAT PUBLIKE"**

**Autore e raportit dhe udhëheqëse e punëtorisë:  
Flaka Xérxa, arkitekte**

**Asistente në realizimin e vizionimit:  
Feray Dervis, arkitekte & Gresa Berisha, studente e arkitekturës**

Observimet në terren janë realizuar nga:  
Dafina Alishani, Duda Bajrami, Fjolla Pupa Shehu, Flaka Xérxa, Gresa Berisha, Mimoza  
Çeku Rogova dhe Valmira Morina

Ky vizionim është produkt i grupit joformal të grave dhe vajzave të Komunës së Prizrenit "FEMaktiv" në bashkëpunim me OJQ "EC Ma Ndryshe".

Raporti është përgatitur në kuadër të projektit "QYTETI GJITHËPËRFSHIRËS – promovimi dhe përhapja e metodologjisë së planifikimit urban me pjesëmarrje" i përkrahur finansiarisht nga Olof Palme International Center, që përkrahet nga Qeveria e Suedisë.





## PËRMBAJTJA

### 0.0 HYRJE

1.0 Punëtoria e vizionimit "Gruaja dhe hapërsira publike - Siguria në hapësirat publike"

- 1.1. Qëllimi i punëtorisë
- 1.2. Metodologja dhe mjetet e punës
- 1.3. Materialet e punëtorisë
- 1.4. Pjesëmarrësit e punëtorisë
- 1.5. Fazat e punëtorisë
- 1.6. Rastet e studimit
- 1.7. Ecuria e punëtorisë

2.0 Rezultatet e punëtorisë

- 2.1. Të dhënat e dalura nga pyetësorët
- 2.2. Të dhënat e dalura nga observimi direkt i hapësirave publike
- 2.2. Identifikimi i problemeve kryesore në hapësirat publike të Prizrenit
- 2.3. Identifikimi i problemeve dhe kërkesave për realizim në lokacionet e përgjedhura

3.0 Vizionimi i kërkesave të punëtorisë

- 3.1. Lokacioni: Rrugët që të dërgojnë në Kala dhe Kalaja, përfshirë Kompleksin e Marashit
- 3.2. Lokacioni: Zona Industriale dhe lidhja me Qendrën Historike, përfshirë hapësirën përreth Stacionit të Autobusëve
- 3.3. Lokacioni: Hapësira publike përreth Palestrës Sportive

### 4.0 Rekomandimet

#### 5.0 Shtojcat

- 5.1. Pyetesori
- 5.2. Hapësirat Publike në Prizren
- 5.3. Lokacionet e përgjedhura për diskutim
- 5.4. Vizuelizim i Lokacionit 1: Rrugët që të dërgojnë në Kala dhe Kalaja, përfshirë Kompleksin e Marashit
- 5.5. Vizuelizim i Lokacionit 2: Zona Industriale dhe lidhja me Qendrën Historike, përfshirë hapësirën përreth Stacionit të Autobusëve
- 5.6. Vizuelizim i Lokacionit 3: Hapësira publike përreth Qendrës Sportive



## HYRJE

Hapësirat publike frekuentohen nga shfrytëzues të ndryshëm. Të moshuar, fëmijë, persona me nevoja të veçanta, gra dhe burra përballen me hapësirat publike në përditshmërinë e tyre, varësisht nga kërkesat dhe nevojat e tyre ditore. Qyteti, me theks në hapësirat e përbashkëta, pra ato publike, dallon nga mënyra se si arrin të përmbush kërkesat e shfrytëzuesve varësisht se në cilën kategori bëjnë pjesë ata.

Edhe pse parimi i barazisë është esencial në mënyrën e funksionimit të qytetit, barazia gjinore del të jetë një prej problematikave kryesore. Hulumtime të shumta kanë dëshmuar për dallimet në shfrytëzim nga ana e burrave dhe grave. Me ndarjen e roleve gjinore në shoqëri, individët përvetësojnë detyra të caktuara duke i diferencuar edhe angazhimet jetësore, rrjedhimisht ato ditore që u takojnë grave dhe burrave. Kjo ndarje është reflektuar edhe në formësimin e pozitës së gruas dhe burrit në raport me qytetin në tërësi, dhe hapësirën publike në veçanti.

Jane Jacobs, aktiviste me theks në diferencimet sociale dhe kulturore të koncepteve urbane të kohës të cilën po e jetonte, në publikimin e saj "The Death and Life of Great American City" deklaron se qytetet mund të ofrojnë diçka për të gjithë, vetëm atëherë kur krijohen nga të gjithë. Mungesa e qasjes gjithëpërfshirëse e ngritur si qështje nga Jacobs që në shek. XX, mbetet ende aktuale edhe në qytetet evropiane. Segregimi gjinor është i pranishëm edhe në qytetet tona, duke favorizuar burrat për lirinë, sigurinë, përshtatshmërinë dhe ndjesinë e mirë në shfrtyëzimin e qytetit. Kushtimisht, gratë mbeten grup i marginalizuar, duke e shfrytëzuar qytetin parcialisht, në shoqëri të tjerëve, me pa siguri dhe me një sërë problematikash përcjellëse.

Gratë duke u kategorizuar sot si "nëna aktive" janë më tepër të angazhuara në obligimet familjare, duke përfshirë këtu përcjelljen e fëmijëve në shkollë, furnizmin, kryerjen e obligimeve të pagesave etj. Mirëpo këto obligime nuk përjashtojnë faktin që ato në mënyrë të barabartë me burrat mundohen të janë aktive në tregun e punës. E tërë kjo i shndërron ato në shfrytëzeset më të mëdha të përbajtjeve publike në qytet. Rezultatet e punëtorisë "Gruaja dhe Hapësira Publike - Siguria në Hapësirat Publike" dëshmojnë për një sërë problemesh me të cilat ato përballen vazhdimisht në qytetin e Prizrenit.

## **1.0 PUNËTORIA E VIZIONIMIT "GRUAJA DHE HAPËSIRA PUBLIKE - SIGURIA NË HAPËSIRAT PUBLIKE"**

### **1.1. Qëllimi i punëtorisë**

Punëtoria "Gruaja dhe Hapësira Publike - Siguria në hapësirat publike" është realizuar nga FEMaktiv, grupei joformal i grave dhe vajzave të Komunës së Prizrenit si dhe OJQ EC Ma Ndryshe. Aktiviteti është mundësuar nga Olof Palme International Center, që përkrahet nga qeveria e Suedisë.

FEMaktiv, që synon të sfidojë mendësinë patriarkale në diskursin publik të qytetit, ka në përbërjen e saj si grup jo formal një numër aktivistesh të cilat përgjatë takimeve konsultative angazhohen në identifikimin e problemeve kryesore të grave dhe vajzave të Komunës së Prizrenit. Siguria në hapësirat publike rezulton të jetë një ndër shqetsimet kryesore në Komunën e Prizrenit.

Kjo problematikë është evidentuar edhe përgjatë hulumtimit vjetor të realizuar nga EC Ma Ndryshe në kuadër të projektit "QYTETI GJITHËPËRFSHIRËS – promovimi dhe përhapja e metodologjisë së planifikimit urban me pjesëmarrje". Kështu në raportin vjetor "Grupet e komunitetit dhe planifikimi urban në Prizren - Qyteti Gjithpërfshirës", gratë zënë pjesë në mesin e shtatë grupeve të marginalizuara të cilat janë trajtuar në kuadër të këtij projekti. Të dhënët e dalura nga fokus grupet me gratë e Komunës së Prizrenit dëshmojnë për një sërë shqetësimesh të tyre lidhur me shërbimet në Prizren dhe shfrytëzimin e hapësirava publike nga ana e tyre. Gratë, përveç se me shumë pakënaqësi lidhur me raportin e tyre me qytetin, janë deklaruar të marrin shumë pak pjesë në diskutimet publike të organizuara nga Komuna, ku do të mund t'i parashtronin kërkesat dhe shqetësimet e tyre. Ndërsa shqetësimet kryesore të pjesëmarëseve në fokus grupe del të jetë cënimi i lëvizjes së lirë në trotuare të cilat rëndom janë të bllokuara nga automjetet e parkuara. Në afërsi të shkollave, trotuaret janë të bllokuara edhe me shitës ambulant, duke u vështirësuar atyre shoqërimin e fëmijëve në shkollë. Pjerrinat janë mungesë në nivel qyteti. Shqetsim i lidhur direkt më hapësirat publike është edhe mungesa e hapësirave të gjelbërta, mungesa e vegjetacionit që do të krijonte hije si dhe mirëmbajtja jo e mirë e tyre dhe stimulimi i pranisë së qenve endacak. (EC Ma Ndryshe, "Grupet e komunitetit dhe planifikimi urban në Prizren - Qyteti Gjithpërfshirës 2014"; [http://www.ecmandryshe.org/repository/docs/Qyteti\\_Gjithperfshires.pdf](http://www.ecmandryshe.org/repository/docs/Qyteti_Gjithperfshires.pdf))

Këto shqetësime janë pasqyruar edhe në analizën e shkurtër "Planifikimi urban për qytetarët 3" në të cilën potencohet shqetësimi i grupit të marginalizuar të

grave lidhur me bllokimin e trotuareve, hapësirat publike të pa ndriçuara, mungesës së gjelbërimit etj. Sipas sondazhit të këtij hulumtimi, shqetësimet kryesore të grave në lidhje me qytetin e Prizrenit rradhitën si vijon: bllokimi i trotuareve me makina, ndërtimet pa leje, mungesa e hapësirave të gjelbëruara, mungesa e parqeve publike, niveli i mirëmbajtjes së hapësirave publike, mungesa e çerdheve, problemet infrastrukturore, shkatërrimi i qendrës historike, ndërtimet e larta në qytet, ndotja akustike etj. (Rozafa Basha, Analizë e shkurtër: Planifikimi Urban për Qytetarët 3, 2014, [http://www.ecmandryshe.org/repository/docs/150203145824\\_EC\\_Planifikim\\_Urban\\_per\\_Qytetaret.pdf](http://www.ecmandryshe.org/repository/docs/150203145824_EC_Planifikim_Urban_per_Qytetaret.pdf)).

Qëllimi i punëtorisë "Gruaja dhe hapësira publike - Siguria në hapësirat publike" është shqyrtimi më i detajuar i shqetësimeve dhe kërkesave të grave dhe vajzave të Komunës së Prizrenit me qëllim të arritjes së propozimeve konkrete të vizionuara të cilat do të mund të adresoheshin deri tek autoritetet përgjegjëse.



*Fig. 1. Pamje nga punëtoria "Siguria në hapësirat publike"*

Kjo punëtori ka për bazë hulumtimet e deritanishme lidhur me raportin e gruas me qytetin, propozimet e dalura nga fokus grupin i realizuar me aktivistet e FEMaktiv, rezultatet e dalura nga punëtoria si dhe të gjeturat nga observimi direkt në lokacionet e shqyrtuara.

## 1.2. Metodologjia dhe mjetet e punës

Punëtoria "Gratë dhe hapësirat publike - Siguria në hapësirat publike" duke patur përfshirjen e grave dhe vajzave të Komunës së Prizrenit, është bazuar në diskutime të hapura me gratë pjesëmarrëse në punëtori lidhur me problematikat e

tyre në raport me hapësirat kryesore publike në Prizren, në plotësim të pyetësorëve lidhur me eksperientat e tyre ditore me qytetin, si dhe punën në grupe ku janë dhënë propozime konkrete lidhur me hapësirat publike të cilat janë trajtuar.

Punëtoria është organizuar gjatë intervalit një ditor, në të cilën paraprakisht janë shpalosur të dhënat nga hulumtimet paraprake të realizuara në këtë temë, të dhënat nga fokus grupi si dhe rezultatet nga observimi i lokacioneve të shqyrtuara.



Fig. 2. Pamje nga fokus grupi në FEMaktiv



Fig. 3. Pamje nga punëtoria me gratë pjesëmarrëse

Punëtoria është konceptuar në tri fazë të punës ku në fazën e parë është diskutuar për sigurinë në hapësirat publike, në fazën e dytë për diferencimin gjinorë në shfrytëzimin e hapësirave publike ndërsa në fazën e tretë janë dhënë propozime konkrete lidhur me rimendësimin e hapësirave të trajtuar.

### 1.3. Materialet e punëtorisë

Për të realizuar të gjitha fazat e punëtorisë, është parë e nevojshme aplikimi i këtyre materialeve:

- pyetësori
- harta të lokacioneve të shqyrtuara
- fotografi të lokacioneve të shqyrtuara
- letër për punimin e maketës
- ngjyra dhe letra me ngjyrë
- laptop dhe projektor

### 1.4. Pjesëmarrëset e punëtorisë

Punëtoria "Gratë dhe hapësirat publike - Siguria në hapësirat publike" ka patur përfshirjen, duke synuar në krijimin e një grupei punues i cili do të përfaqëson gra dhe vajza të grupmoshave të ndryshme, të angazhimit intelektual të ndryshëm, të statusit social të ndryshëm si dhe përfshirjen e grave dhe vajzave

me nevoja të veçanta.

Pjesëmarrëset e ftuara në punëtori kanë kontibuar me përvojat e tyre ditore në shqyrtimin e kërkesave dhe propozimeve konkrete për lokacionet e shqyrtuara. Gratë tashmë pensionere kanë rrëfyer për raportin e tyre me qytetin, pakënaqësitë dhe shqetësimet që lidhen me përditshmërinë e tyre. Punonjëset e insituacioneve të ndryshme kanë shpalosur kërkesat e tyre që lidhen me hapësirat të cilat i shfrytëzojnë gjatë shkuarjes në vendet e punës dhe më tepër, në hapësirat të cilat lidhen me kujdesin ndaj fëmijëve të tyre. Nënat e reja kanë treguar eksperiencat e tyre para dhe pas këtij statusi, duke krahasuar kërkesat e dikurshme me të tanishme dhe duke patur përfshirje përfshirje që ato i hasin sidomos në mungesën e pjerrinave dhe stacioneve të autobusëve.



Fig. 4. Illustrim i pjesëmarrjes gjithëpërfshirëse në punëtori

Si komponentë e rëndësishme e grave pjesëmarrëse në punëtori ishte përfshirja e grave dhe vajzave me nevoja të veçanta, të cilat duke marrur shembuj konkret nga përditshmëria, kanë dëshmuar përfshirje përfshirje barrierat e shumta fizike dhe sociale të cilat ato i kanë në raport me qytetin.

Në punëtori janë ftuar edhe gra profesioniste, të cilat me përvojën e tyre shumëvjeqare në gjyqësor, kanë kontribuar duke dhënë propozime përfshirje konkrete lidhur me përmirsimin e situatës së sigurisë në hapësirat publike në Prizren.

## 1.5. Fazat e punëtorisë

Me qëllim të trajtimit të gamës së gjerë të problematikave të cilat gratë dhe vajzat mund t'i kenë në raport me qytetin, punëtoria ka filluar me një diskutim të përgjithshëm. Diskutimi ka patur përfshirje përfshirje synim të listojë shqetësimet kryesore në hapësirat publike të Prizrenit lidhur me sigurinë dhe shfrytëzueshmërinë e tyre nga gratë dhe vajzat. Në këtë pjesë të punëtorisë janë vënë në pah një sëri problematikash që lidhen me eksperiencat ditore të pjesëmarrëseve të punëtorisë.

Në etapat e mëtutjeshme të punëtorisë, me qëllim të arritjes së propozimeve

konkrete, puna është kategorizuar në tri faza të diskutimeve. Të trija këto faza në fund të punëtorisë kanë komplementuar njëra tjetrën, duke ndikuar që kërkesat e pjesëmarrësve lehtë të mund të pasqyrohen në zgjidhje të vizionuara.

## FAZA I

**Siguria në hapësirat publike**

Skicim i problematikave në tri hartat e lokacioneve përkatëse

## FAZA II

**Diferencimi gjinor i shfrytëzimit të hapësirave publike**

Diskutim dhe plotësim pyetësorësh

## FAZA III

**Propozime për ri-mendësimin e hapësirave publike të trajtuar**


Diskutim i aktiviteteve

*Fig. 5. Skema e fazave të punëtorisë*

### 1.6. Rastet e studimit

Në diskutimin i cili është inicuar në fillim të punëtorisë janë trajtuar hapësirat kryesore publike në qytetin e Prizrenit. Pjesëmarrëseve u është kërkuar që të flasin për përvajat e tyre ditore në hapësirat të cilat janë më të frekuentueshme nga ana e tyre, duke përfshirë këtu: Shadërvanin, Kompleksin e Marashit, Sheshin e Lidhjes, Kejin - segmenti te Ura Arasta, Kejin - segmenti te Beledija, hapësirën publike te Palestra Sportive, rrugën Remzi Ademi, hapësirën publike në lagjen Ortakoll, hapësirën publike në lagjen Bazhdarhane, shëtitoren për në Kala (rruga malore), shëtitoren për në Kala (rruga turistike), Kalanë, Parkun e Qytetit, Tregun e Gjelbërt, hapësirat publike te Stacioni i Autobusëve.

Trajtimi i hapësirave kryesore publike në Prizren ka sjellur të dhëna lidhur me problematikat kryesore në nivel qyteti.



*Fig. 5. Ilustrim i hapësirave kryesore publike në Prizren*

1. Parku i Qytetit, 2. Hapësira publike rreth Stacionit të autobusëve, 3. Keji - Segmenti te Beledija, 4. Shadërvani, 5. Keji - Segmenti te Ura Arasta, 6. Kalaja dhe rrugët që të dërgojnë në Kala, 7. Hapësira Publike në Lagjen Ortakoll, 8. Tregu i Gjelbërt, 9. Rruga Remzi Ademi, 10. Hapësira Publike në Lagjen Bazhdarhane, 11. Hapësira Publike te Palestra Sportive

Paraprakisht, në fokus grupin e organizuar para mbajtjes së punëtorisë, është diskutuar lidhur me mundësinë e përzgjedhjes së tri lokacioneve të cilat do të mund të trajtohen më detajisht. Pjesëmarrëset kanë rradhitur përparësitë dhe mangësitë në secilën nga hapësirat publike të Prizrenit, duke prioritizuar ato që janë më problematiket dhe me më shumë potencial për përmirsim në të ardhmen. Duke analizuar hapësirat të cilat janë më problematike për gratë dhe vajzat e Komunës së Prizrenit sa i takon sigurisë, lokacionet e përzgjedhura ishin:

1. *Rrugët që të dërgojnë në Kala dhe Kalaja, përfshirë Kompleksin e Marashit*  
Pjesëmarrëset e fokus grüpuit kanë përzgjedhur për diskutim më të hollësishëm këtë zonë, për shkak të shqetësimit të tyre lidhur me sigurinë e grave dhe vajzave. Ato janë deklaruar se pothuajse asnjëhere nuk u ka rastisur të shohin gra të vetme të cilat dalin për të ecur përgjatë rrugës malore\* apo asaj turistike\* që të dërgon



*Fig. 5. Pozita e lokacioneve të përzgjedhura për diskutim në kuadër te qytetit*

në Kala. Rëndom gratë dhe vajzat detyrohen të shoqërojnë njëra tjetrën apo të jenë në shoqëri të palëve të treta në mënyrë që të kalojnë kohën e tyre në këto hapësira. Në orët e vona qarkullimi i tyre është i pamundshëm për shkak të mungesës së ndriçimit.

## *2. Zona Industriale dhe lidhja me Qendrën Historike, përfshirë hapësirën përreth Stacionit të Autobusëve*

Me zhvillimin e pjesës perëndimore të Prizrenit, Zona Industriale pësoj shtesë të përmbajtjeve të reja funksionale. Numri i madh i ndërtimeve të objekteve shumëbanesore në afersi të saj, shtuan numrin e popullsisë në këtë pjesë të qytetit. Ndërsa përmbajtjet afariste në këtë zonë, plotësojnë nevojat ditore të banorëve të Prizrenit. Pjesëmarrëset e punëtorisë kanë parë të arsyeshme diskutimin e lidhjes së kësaj hapësire me qendrën e qytetit, duke përfshirë edhe Stacionin e Autobusëve. Meqenëse transporti publik nuk është i zgjidhur për këtë pjesë, gratë dhe vajzat duhet të shfrytëzojnë vetëm automjetet private që të mund të frekuentojnë këtë zonë të qytetit. Ato janë të privuara që si këmbësore të qarkullojnë për të shkuar në Zonën Industriale apo anasjelltas, për tu kthyer në qendrën e qytetit. Mungesa e lidhjes së duhur me qendrën, mungesa e ndriçimit dhe përmbajtjeve aktive janë parë të jenë disa nga problematikat që duhet të diskutohen për këtë lokacion.

### *3. Hapësira Publike përreth Qendrës Sportive*

Një prej hapësirave me sipërfaqe më të madhe gjelbëruese dhe me më së shumti potential për shfrytëzim, nga pjesëmarrëset e punëtorisë është konstatuar të jetë hapësira përreth Palestrës Sportive në Prizren. Fatkeqësisht kjo zonë është e dominuar nga burrat, duke qenë se shfrytëzimi i përbajtjeve sportive dominohet më së shumti nga ta. Prania e përbajtjeve jo të mira në afërsi (kafeneve me shfrytëzim vetëm nga burrat) dhe paragjykimet nga ana tyre për tu shfrytëzuar hapësirat sportive edhe nga ana e grave dhe vajzave, ka bërë që ky lokacion të listohet në rradhën e lokacioneve për shqyrtim më të detajuar.

#### **1.7. Ecuria e punëtorisë**

Pas kohës së dedikuar për diskutim lidhur me shqetësimet dhe kërkesat kryesore sa i takon hapësirave publike në Prizren, puntoria e vizionimit ka patur për fokus realizimin e fazave të paracaktuara në metodologjinë e punës. Në fund të diskutimit, pjesëmarrësit kanë plotësuar pyetësorët e shpërndarë, të cilët janë përpiluar paraprakisht duke u bazuar në metodologji të aplikuara tashmë për planifikimin urban me pjesëmarrje. Për personat me nevoja të veçanta të pranishme në punëtori (rasti: person me pengesa në shikim) është ofruar asistencë gjatë përpilimit të pyetësorit. Rezultatet e anketës janë prezantuar më poshtë në raport, së bashku me rezultatet e observimit direkt nga ana e aktivistëve të FEMaktiv (të zhvilluar paralelisht).



*Fig. 6. Identifikimi i mangësive në lokacionet e shqyrtuara*

Pas përfundimit të diskutimit të hapur dhe plotësimit të pyetësorëve individual, pjesëmarrëset janë ndarë në tri grupe, për të diskutuar më detajisht tri lokacionet e zgjedhura paraprakisht gjatë fokus grupit. Pjesëmarrëset janë ndarë në lokacionet e caktuara në bazë të preferencave të tyre, duke u pozicionuar në lokacionet të cilat kanë qenë më familjare për to. Secili lokacion është spjeguar paraprakisht për pjesëmarrëset, sa i takon pozitës në kuadër të qytetit, dhe gjendjes aktuale (të ilustruar përmes fotografive). Pjesëmarrëseve u janë shpërndarë ortofoto të tri

lokacioneve së bashku me mjetet e punës.

Fillimisht në hartat e pregaditura janë identifikuar problemet dhe shqetësimet kryesore lidhur me lokacionin e shqyrtuar. Në fokus ishin qështjet e diferencimit gjinor të shfrytëzimit të hapësirave publike dhe siguria në hapësirat publike.

Pas përfundimit të fazës së parë dhe të dytë, ka filluar faza përfundimtare, ajo e rimendësimit të hapësirave publike të trajtuar. Duke u nisur nga preferencat e secilës pjesëmarrëse në diskutime, me ndihmën e fasilitatorëve, secili grup ka prioritizuar kërkesat dhe më pas ka dhënë propozime konkrete lidhur me përmirësimin e kualitetit të hapësirave publike të shqyrtuara.

Një përfaqësues i secilit grup në fund ka bërë prezentimin e mangësive dhe përparësive të secilit lokacion, duke u fokusuar më pas në propozimet për rimendësimin e tyre. Në këtë mënyrë të gjitha pjesëmarrëset kanë arritur që të fitojnë përshtypjet e para lidhur me propozimet që do të dalin për secilin lokacion në veçanti.




Fig. 7. Pozita e lokacioneve të përzgjedhura për diskutim në kuadër te qytetit

Pas prezentimeve nga përfaqësuesit e secilit grup, gratë pjesëmarrëse kanë patur rastin që t'i drejtojnë kërkesat e tyre direkt te përfaqësuesja e Komunës së Prizrenit nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, e cila ishte e pranishme në punëtori. Veç të tjera shpërndarëset kanë diskutuar për format e mundshme të veprimit për t'i aktualizuar kërkesat e tyre, ndërsa të cilat kanë përmendur edhe peticonet dhe performancat e ndryshme publike.

## 2.0 REZULTATET E PUNËTORISË

### 2. 1. Të dhënat e dalura nga pyetësorët

Të gjitha pjesëmarrëset iu nënshtruan procesit të plotësimit të pyetësorëve, gjithsejt 17. Në mesin e pjesëmarrëseve kishte profesioniste të lëmive të ndryshme: juriste, ekonomiste, mësimdhënëse, veterane të arsimit, psikologe, dizajnere, inxhiniere, muzikante, arkitekte, punëtore sociale. Të pranishme ishin edhe gratë amvise si dhe ato tashmë të pensionuara. Në rradhën e pjesëmarrëseve kishte edhe studente. Kategorizimi i pjesëmarrëseve sa i takon moshës është prezentuar më poshtë (graf.01).



Graf.1. Pasqyra e pjesëmarrëseve sipas moshës

Më posht është shpalosur një shembull i pyetësorit të ndarë te pjesëmarrëset e punëtorisë, me gjithsejt 11 pyetje.

EMRI (OPSIONALE):

MOSHA:

PROFESIONI:

1. A ndjeheni e sigurtë në hapësira publike?
  - a. Po
  - b. Jo
  - c. Pjesërisht
  
2. Nëse jo, cilat nga arsyet e mëposhtme ndikojnë në pasigurinë tënde?
  - a. Mungesa e ndriçimit publik
  - b. Prania e qenve endacak
  - c. Prania e grupeve të dyshimta
  - d. Menaxhimi jo i mirë i hapësirave publike
  - e. Ngacmimi nga burrat
  - f. Kanosja nga pakujdesia në trafik
  - d. Tjetër (listo arsyet të tjera)


3. Cilat nga hapësirat e mëposhtme i shfrytëzoni më shumë dhe në cilin interval kohorë?
- Shadërvani \_\_\_\_\_
  - Kompleksi I Marashit \_\_\_\_\_
  - Sheshi i Lidhjes \_\_\_\_\_
  - Keji - segmenti te Ura Arasta \_\_\_\_\_
  - Keji - segmenti te Beledija \_\_\_\_\_
  - Hapësira publike te Palestra Sportive \_\_\_\_\_
  - Rruga Remzi Ademi \_\_\_\_\_
  - Hapësira publike në lagjen Ortakoll \_\_\_\_\_
  - Hapësira publike në lagjen Bazhdarhane \_\_\_\_\_
  - Shëtitorja për në Kala (rruga malore) \_\_\_\_\_
  - Kalaja \_\_\_\_\_
  - Parku i qytetit \_\_\_\_\_
  - Tregu i gjelbërt \_\_\_\_\_
  - Hapësira publike te stacioni i autobusëve \_\_\_\_\_
4. Cili aktivitet e përcjell shfrytëzimin tënd të hapësirës publike?
- Kalimi i kohës së lirë
  - Ecja dhe vrapimi
  - Ushtrimet fizike
  - Dalja në pauzën e drekës
  - Leximi
  - Shoqërimi i familjarëve (prindërve, fëmijëve etj)
  - Vrapimi
  - Socializimi me të tjera
  - Shoqërimi i kafshëve shtëpijake
  - Pirja e kafes në ndonjë lokal afér
5. Sipas vlerësimit tuaj të përgjithshëm, a kanë infrastrukturëdhe shërbime të duhura publike hapësirat publike në Prizren?
- Ndriçim publik
  - Hapësira për ulje
  - Hapësira gjelbëruese
  - Toalete
  - Ujë
  - Parqe për fëmijë
  - Patrolla të Policisë
  - Shërbime të duhura komunale
6. A mendoni se hapësirat publike në Prizren janë të dominuara nga burrat?
- Po
  - Jo
7. Nëse po, a ju limiton ky fakt në shfrytëzimin e hapësirës publike?
- Po
  - Jo
8. A jeni ngacmuar ndonjëherë gjatë shfrytëzimit të hapësirës publike (përfshirë komentet jo të dëshirueshme gjatë qëndrimit apo ecjes)?
- Po
  - Jo
9. Nëse po, a e keni raportuar ndonjëherë këtë në organet e rendit?
- Po
  - Jo
10. Bazuar në situatën aktuale, a është hapësira publike në Prizren vend i mundshëm për gjidhënje?
- Po
  - Jo

11. Cilat nga elementet e mëposhtme do të përmirësonin shfrytëzimin e hapësirave publike në Prizren?
- Siguri më e madhe në lëvizje dhe qëndrim
  - Aktivitete të ndryshme kulturore
  - Aktivitete të ndryshme sportive
  - Aktivitete për fëmijë
  - Infrastrukturë më e mirë publike
  - Shërbime më të mira komunale

*Fig. 8. Mostra e pyetësorit të punëtorisë*

Rezultatet e anketimit janë prezëntuar më poshtë, duke dhënë grafikisht të paraqitura përgjegjet e pjesëmarrësve si dhe komentet lidhur me ndikimin e rezultateve në procesin e vizionimit.


### ■ 1. A ndjeheni e sigurtë në hapësira publike?



70% e të anketuarave kanë deklaruar se nuk ndihen të sigura në hapësirat publike në Prizren, ndërsa 18% se ndihen pjesërisht të sigura. Vetëm 12% kanë deklaruar se ndihen të sigura.

Përqindja e lartë në favor të josigurisë nxit kurreshjen për një sërë faktorësh që mund të kenë shtyer të anketuarat të mos ndihen të sigura në hapësirat të cilat ato i frekuentojnë.


### ■ 2. Nëse jo, cilat nga arsyet e mëposhtme ndikojnë në pasigurinë tënde?



Të anketuarat kanë vënë më pak se prania e qenve endacak mbizotëron mbi të gjitha arsyet tjera që ndikojnë në pasigurinë e tyre në hapësira publike, duke u përcjellur me mungesën e ndriçimit publik, kanosjen nga pakujdesia në trafik si dhe ngacmimet nga burrat.

Ndër arsyet e tjera me më pak përqindje janë listuar prania e grupeve të dyshimta si dhe menaxhimi jo i mirë i hapësirave publike.


### 3. Cilat nga hapësirat e mëposhtme i shfrytëzoni më shumë dhe në cilin interval kohorë?



Shadërvani mbetet ndër hapësirat më të frekuentuara nga ana e të anketuarave, pa marr parasysh moshën e tyre. Ai shfrytëzohet gjatë gjithë ditës, duke i lënë vend Kompleksit të Marashit për të cilin të anketuarat janë dekluaruar se e vizitojnë më së shumti në mëngjes dhe atë gjatë sezonit të verës.


Hapësira publike në afërsi të Palestrës Sportive del të jetë hapësira më së paku e shfrytëzuar nga gratë dhe vajzat, me vetëm 1%.

### 4. Cili aktivitet e përcjell shfrytëzimin tënd të hapësirës publike?




Kalimi i kohës së lirë, frekuentimi i ndonjë lokalit në afërsi, ecja dhe socializimi me të tjerrë, janë arsyet që kanë dominuar në pyetjen mbi arsyen e shfrytëzimit të hapësirave publike. Pason shoqërimi i familjarëve dhe leximi. Ndërsa në përqindje shqetësuese mbetet kryerja e ushtrime fizike, vrapimi apo shoqërimi i kafshëve.

### 5. Sipas vlerësimit tuaj të përgjithshëm, a kanë infrastrukturë dhe shërbime të duhura publike hapësirat publike në Prizren?




Pjesëmarrëset e punëtorisë janë dekluaruar për nevojën e përfshirjes së hapësirave për ulje në kuadër të hapësirave publike. Poashtu sipas tyre toaletet publike dhe ndriçimi publik do të përmirësonin kualitetin e këtyre hapësirave. Të anketuarat janë dekluaruar për nevojën e patrollave të policisë për siguri më të madhe. Gratë dhe vajzat kanë kërkuar më shumë hapësira gjelbëruese dhe parqe përfëmijë.

■ 6. A mendoni se hapësirat publike në Prizren janë të dominuara nga burrat?




82% e të anketuarave janë deklaruar se mendojnë se hapësirat publike janë të dominuara nga burrat. Vetëm 18% kanë dhënë përgjegje negative në këtë pyetje. Vlen të ceket se grupmoshat e shtyera janë ato që kanë mohuar që sipas pikëveshtrimit të tyre, hapësirat publike të janë të dominara nga burrat. Kjo lë të kuptohet se grupmoshat e reja ndikohen më shumë nga dominimi i burrave në hapësirat që ato do të dëshironin t'i frekuentonin.

■ 7. Nëse po, a ju limiton ky fakt në shfrytëzimin e hapësirës publike?



10 nga të anketuarat kanë deklaruar se përkundër faktit që mendojnë se hapësirat publike janë të dominuara nga burrat, ato nuk limitohen në shfrytëzimin e tyre. Të tjerat kanë dëshmuar që ky fakt mund edhe t'i limitojë në shfrytëzimin e lirshëm të hapësirave të cilat ato me dëshirë do t'i frekuentonin.


■ 8. A jeni ngacmuar ndonjëherë gjatë shfrytëzimit të hapësirës publike (përfshirë komentet jo të dëshirueshme gjatë qëndrimit apo ecjes)?



Shumica e të anketuarave janë deklaruar pozitivisht në pyetjen nëse janë ngacmuar gjatë shfrytëzimit të hapësirave publike, duke pasqruar një gjendje alarmante sa i përket nivelit të sigurisë në Prizren.


Vlen të ceket se përgjegjet negative sërisht janë dominuar nga grupmoshat e shtyera, duke filluar nga 50 vjeç e mbi.

**9. Nëse po, a e keni rapportuar ndonjëherë këtë në organet e rendit?**



Përkundër përqindjes së lartë të ngacmimive përgjatë shfrytëzimit të hapësirave publike apo ecjes nga një vend në tjetrin, të anketuarat janë përgjegjur negativisht lidhur me faktin se a i kanë rapportuar këto raste në organet përgjegjëse. Vetëm një person është deklaruar ta ketë lajmëruar rastin.


**10. Bazuar në situatës aktuale, a është hapësira publike në Prizren vend i mundshëm për gjidhënje?**



94% e të anketuarave është përgjegjur negativisht lidhur me mundësinë që nënët t'i shfrytëzojnë hapësirat publike në Prizren për gjidhënje.

Disa nga to madje kanë komentuar që do të ishte mirë që një gjë e tillë të ishte e mundur, por që mentaliteti i ynë ende nuk e toleron këtë.

**11. Cilat nga elementet e mëposhtme do të përmirësonin shfrytëzimin e hapësirave publike në Prizren?**




Lidhur me elementet që do të përmirësonin kualitetin e hapësirave publike në Prizren, të anketuarat janë deklaruar me përqindjen më të madhe për sigurinë në lëvizje dhe qëndrim me 21%, për të vazhduar me shërbime më të mira komunale, infrastrukturë më të mirë publike, aktivitete të ndryshme kulturore si dhe aktivitete përfëmijë. Aktivitetet sportive janë listuar me përqindjen më të ulët.

## 2.2. Të dhënat e dalura nga observimi direkt i hapësirave publike


Observimet në terren janë zhvilluar paralelisht me punëtorinë, nga ana e aktivisteve të FEMaktiv. Qëllimi për realizimin e vizitave dhe numërimin e kalimtarëve lidhet direkt me krijimin e një përshtypje të përgjithshme lidhur me numrin e shfrytëzusve të hapësirave publike dhe dominimin ose jo të tyre nga ana e burrave. Në fokus ishin tri lokacionet e përzgjedhura për vizionim, ku shifrat e dalura nga terreni do të ndihmonin drejtpërsëdrejti në identifikimin e problemeve në lokacionet përkatëse, varësisht nga numri i madh ose i vogël nga ana e grave dhe vajzave. Aktivistet janë ndarë në tri lokacione, ku në tri intervale të ndryshme kohore kanë bërë numërimin e kalimtarëve përgjatë 15 minutave. Me qëllim të krijimit të përshtypjes mbi shfrytëzimin e hapësirave publike në intervale të ndryshme kohore përgjatë ditës, janë përzgjedhur këto intervale: në mëngjes 09:00 H, gjatë ditës 15:00 H dhe në mbrëmje 20:00 H.

Më poshtë janë prezantuar rrezultatet e observimit në tri lokacionet e përzgjedhura për diskutim përgjatë punëtorisë.



Graf.2. Pasqyra e kalimtarëve në lokacionin nr.1 - Kalaja/  
Ruga turistike


Nga observimet direkte në terren, del se në lokacionin nr.1, Kalanë dhe rrugët që të dërgojnë në Kala, duke përfshirë Kompleksin Marash, ekziston një lëvizje tëjet e vogël e grave dhe vajzave të pa shoqëruara. Praktikisht, ato nuk marrin rrugë për në Kala të vetme, por të shoqëruara me gra të tjera apo në prani të burrave. Periudha më e vizituar krahasuar me tri periudhat përgjatë së cilave është bërë observimi, është ora 15:00. Gratë në këtë periudhë e shfrytëzojnë rrugën turistike që të dërgon në Kala të shoqëruara nga gra të tjera, të shoqëruara nga burrat por edhe fëmijët. Kjo rrugë është e pa shfrytëzuar nga gratë në orët e mbrëmjes, si mungesë e ndriçimit dhe përbajtjeve aktive që do të mund të rrisnin sigurinë e tyre. Në të kundërtën burrat vërehen ta frekuentojnë edhe në mbrëmje, edhe pse në numër shumë të vogël.



Graf.3. Pasqyra e kalimtarëve në lokacionin nr.1 - Kalaja/ Rruga malore & Kompleksi i Marashit

Krahasuar me rrugën turistike që të dërgon në Kala, Kompleksi i Marashit është më i frekuentuar përgjatë tri intervaleve kohore të shqyrtuara. Numri i personave në lëvizje përgjatë mostrës 15 minutëshe dallon shumë nga rasti i rrugës turistike. Kjo hapësirë publike del të jetë më e sigurtë për lëvizje sa i takon grave dhe vajzave, të vetme apo të shoqëruara me të tjerë. Sidoqoft gratë që dalin të vetme janë shumë pak në numër krahasuar me ato që dalin të shoqëruara nga gratë tjera apo nga burrat. Në orët e mbrëmjes intenziteti i lëvizjes bie dukshëm për të gjitha kategoritë.


Vlen të theksohet se situata ndryshon sa i përket shfrytëzuesve të Kompleksit Marash dhe atyre që marrin drejtim për në rrugën malore. Nuk janë vërejtur gra të vetme të cilat janë drejtuar në këtë rrugë, ndërsa përjashtim bënë numri i grave të shoqëruara me familjarë.



Graf.4. Pasqyra e kalimtarëve në lokacionin nr.2 - Zona Industriale

Përkundër faktit që kjo zonë nuk është trajtuar në aspektin urbanistik, dhe lidhja e krijuar është tërësisht jo-formale, observimet tregojnë se ajo shfrytëzohet shumë nga qytetarët. Më së shumti në mëngjes dhe në mësditë, kjo lidhje e vetë krijuar

nga ta, shfrytëzohet për të kaluar në Zonën Industriale (për të shkuar në vende të punës, për shërbime të ndyshme etj), apo edhe e anasjellta, për të vazhduar tek Qendra Historike. Gra të vetme vërehen vetëm gjatë dy intervalave të para, ndërsa në mbërmjë ato nuk praktikojnë ta shfrytëzojnë këtë pjesë të qytetit, duke preferuar që të ecin në distanca më të gjata, aty ku rrugët janë të ndriquara. Fakti që zona në afërsi të Stacioni të Autbusëve ka aktivitete të dyshimta, nuk ka ndriçim të mjaftueshëm dhe ka prani të qenve endacak, sigurisht që i privon gratë ta shfrytëzojnë këtë kalim gjatë mbrëmjes. Kështu në mostrën e orës 20:00, gratë nuk janë parë të lëvizin të vetme në këtë zonë.



Graf.5. Pasqyra e kalimtarëve në lokacionin nr.3 - Palestro Sportive

Hapësira publike rreth Palestroës Sportive mbetet ndër lokacionet më shfrytëzueshmëri më të ulët, krahasuar me dy lokacionet e tjera të përgjedhura. Edhe pse me një hapësirë gjelbëruese shumë të madhe dhe me mundësi të aktiviteteve të shumta për tu zhvilluar në këtë hapësirë, kjo zonë del të mos jetë shumë atraktive për kalimtarët, banorët në afërsi apo punonjësit e institucioneve në afërsi. Nga observimet vërehet një shfrytëzim më i madh në intervalin e dytë të analizuar, d.m.th në mostrën e orës 15:00. Është interesante të vërehet se ato dominojnë për nga shfrytëzimi në këtë orë, në krahasim me burrat. Kjo duket të jetë për shkak të sigurisë që ato kanë në shfrytëzim të kësaj hapësire përderisa ajo është e ndriçuar. Ndërsa në mostrën e orës 20:00 asnjë grua apo vajzë e vetme nuk kalon në këtë zonë. Kjo sërisht lidhet direkt me faktin që kjo hapësirë është shumë pak e ndriçuar gjatë mbrëmjes. Ndryshtë në hapësirën në afërsi të objekteve shumëbanesore, vërehet lëvizje më e madhe e grupeve të organizuara, sidomos e grupeve të fëmijëve të grupmoshave të ndryshme dhe përcjellësve të tyre.


Në mënyrë tabelarë më poshtë janë prezantuar mostrat e numrimeve të ndara në tri interval kohore për tri lokacionet e shqyrtauara. Për shkak të shtrirjes së gjere, lokacioni nr.1 është vëzhguar në dy pozicione, në rrugën që të dërgon në Kala nga Qendra Historike (\*turistike), dhe rrugën që të dërgon në Kala nga Kompleksi i Marashit (\*malore).

## KALAJA DHE RRUGËT QË TË DËRGOJNË NË KALA (\*TURISTIKE)

	GRUA (vetëm)	GRUA +1	GRUA + BURRË	GRUA + FËMIJË	FAMILJE (grup pers.)	BURRË (vetëm)	BURRË +1
09:00							
15:00							
20:00							

Tabela 1. Pasqyra e lëvizjeve në lokacionin Nr.1 - Kalaja dhe rrugë që të dërgojnë në Kala / Rruga Turistike

## KALAJA DHE RRUGËT QË TË DËRGOJNË NË KALA (KOMPLEKSI MARASH & RRUGA MALORE)

	GRUA (vetëm)	GRUA +1	GRUA + BURRË	GRUA + FËMIJË	FAMILJE (grup pers.)	BURRË (vetëm)	BURRË + 1
09:00	 	 	  		 		
15:00	 	    	 		 		
20:00	 	 	  	 	 		

*Tabela 2. Pasqyra e lëvizjeve në lokacionin Nr.1 - Kalaja dhe rrugë që të dërgojnë në Kala / Rrugë Malore dhe Kompleksi Marash*

## ZONA INDUSTIALE DHE LIDHJA ME QENDRËN HISTORIKE / STACIONI I AUTOBUSËVE

	GRUA (vetëm)	GRUA +1	GRUA + BURRË	GRUA + FËMIJË	FAMILJE (grup pers.)	BURRË (vetëm)	BURRË +1
09:00	 	 	 			 	
15:00	 	 	  			 	
20:00		 	 			 	

*Tabela 3. Pasqyra e lëvizjeve në lokacionin Nr.2 - Zona Industriale dhe lidhja me Qendrën Historike /Stacioni i Autobusëve*

## HAPËSIRA PUBLIKE PËRRETH QENDRËS SPORTIVE

	GRUA (vetëm)	GRUA +1	GRUA + BURRË	GRUA + FËMIJË	FAMILJE (grup pers.)	BURRË (vetëm)	BURRË +1
09:00							
15:00							
20:00							

*Tabela 4. Pasqyra e lëvizjeve në lokacionin Nr.3 - Hapësira Publike përreth Palestrës Sportive*

## **2.2. Identifikimi i problemeve kryesore në hapësirat publike të Prizrenit**

Përpos të gjeturave nga rrezultatet e pyetësorëve me pjesëmarrëset e anketuara si dhe observimi direkt i tri lokacioneve të marra për shqyrtim, diskutimi i hapur në pjesën e parë të punëtorisë ka dhënë një sërë rrezultatesh sa i takon problematikave dhe propozimeve lidhur me hapësirat publike në kontekst të qytetit.

Të pranishmet kanë shpalosur kërkesat e tyre lidhur me hapësirat të cilat më së shumti i frekuentojnë në baza ditore. Në të përgjithshme, disa nga kërkesat që do të përmirësonin drejtpërsëdrejti kualitetin e hapësirave publike në përgjithsi dhe raportin e grave me qytetin në veçanti janë:

### **1. PRANIA E POLICËVE SOCIAL**

Është folur për praktika tashmë të zbatuara në Prizren dhe më gjërë të cilat, sipas pjesëmarrësve paraqesin shembuj të mirë dhe që ia vlen të përvetësohen sërisht. Duke marr parasysh numrin e madh të incidenteve nga grupet e dyshimta, mungesën e ndriçimit, vandalizmat e ndryshme dhe pasigurinë në qarkullim, pjesëmarrëset kanë propozuar që të praktikohet prania e përhershme e 'Politic Social' i cili do të qarkullonte në lagje të caktuara, në principin që secila lagje të jetë nën mbikqyrjen e një autoriteti policor të caktuar. Në këtë mënyrë do të rritej niveli i sigurisë në lëvizje, dhe kjo do të ndikonte drejtpërsëdrejti në lirinë e lëvizjes dhe shfrytëzimit të hapësirave publike nga gratë.

Të pranishmet kanë potencuar edhe problemin e qarkullimit të sëmurve mendorë, sidomos në orët e hershme të mëngjesit. Gjendja e tyre jo-stabile ka shtyer në kanosjen e grave dhe vajzave të cilat drejtohen në vendet e tyre të punës në orët e hershme të mëngjesit. Prania e policëve social do të ndihmonte në zgjedhjen edhe të kësaj problematikë.

### **2. MË SHUMË NDRIÇIM NË HAPËSIRAT PUBLIKE**

Gratë dhe vazjat kanë ngitur shqetsimet e tyre lidhur me lagje të caktuara të cilat nuk kanë fare ndriçim apo janë pjesërisht të ndriçuara, duke i limituar ato në mundësinë për të lëvizur të sigurta në orët e mbrëmjes. Ato kanë kërkuar bashkëpunim më të madh të organeve përgjegjëse nga Komuna e Prizrenit dhe KEDS, në mënyrë që të praktikohet ndriçimi i pa kontestueshëm i hapësirave publike, përfshirë këtu sheshet, parqet e deri të rrugët.

### **3. LIRIMI I TROTUAREVE**

Të pranishmet kanë shprehur shqetsimet e tyre lidhur me nivelin e bllokimit të trotuareve në Prizren, duke vërtetuar shqetësimet e bartura nga hulumtimet viteve të fundit lidhur me këtë problematikë. Gratë që i takojnë grupmoshave më të shtyera, kanë konkretizuar problematikën duke marrë shembuj se gjatë dërgimit të

mbesave dhe nipërve të tyre në shkollë, ato duhet të ecin në rrugën automobilistike, gjë që paraqet një rrezik të madh. Poashtu nënët e pranishme kanë dëshmuar për praktikë të njejtë sa i takon qarkullimit me fëmijët e tyre në karrocë, duke e alarmuar faktin që trotuaret u takojnë automjeteve dhe jo këmbësorëve. Të pranishmet kanë kërkuar që autoritetet lokale të gjejnë mënyra efektive për ta zgjidhur përfundimisht këtë problematikë.

#### 4. NDALIMI I KEQPËRDORIMEVE TË HAPËSIRAVE PUBLIKE

Shqetësim i grave dhe vajzave mbetet keqpërdorimi i hapësirave publike nga ana e bizneseve, me theks në kafenetë dhe restorantet, të cilat ushtrojnë aktivitetin e tyre në hapësirat publike të cilat do të duhet tu takonin vetëm qytetarëve, pa i detyruar ata t'i shfrytëzojnë këto hapësira në këmbim të një kosto të caktuar. Pjesëmarrëset në punëtori kanë kërkuar më shumë vemendje në menaxhimin e hapësirave publike në Prizren.

#### 5. MENAXHIMI I GRUPEVE TË DYSHIMTA TË ORGANIZUARA - LYSARËT

Shqetësuese ka dal të jetë numri i madh i të miturve, të miturve me nënët e tyre dhe qytetarëve të tjerë të cilët qarkullojnë në hapësirat publike dhe në kafenetë e ndryshme duke kërkuar lëmoshë. Pjesëmarrëset e punëtorisë me përvojë në qështjen e sigurisë kanë thënë të jetë e domosdoshme që këto grupe të kontrollohen në mënyrë që të zbulohen personat të cilët në mënyrë të dyshimtë i menaxhojnë dhe stimulojnë ata. Gratë dhe vajzat kanë treguar se ndihen të kanusura në prani të këtyre grupeve të organizuara.

#### 6. APLIKIMI I STACIONEVE TË AUTOBUSËVE LOKAL

Nënët me fëmijë sidomos kanë shprehur kërkesën e tyre të lidhur me transportin publik, duke dëshmuar që ato në kushte të ndryshme klimatike e kanë të pamundshme t'i shfrytëzojnë autobusët për shkak të mungesës së stacioneve të mbuluara. Stacione të disazjnuara sipas kërkesave të komunitetit do tu lëhtësonin qarkullimin ditorë edhe grupmoshave të shtyera, të cilat nuk kanë se ku të ulen përdersia pres in për autobusin e tyre lokal.

#### 7. MENAXHIMI I ZONËS HISTORIKE - SHADËRVANI

Përpos komenteve për degradimin e Zonës Historike, aplikimeve të objekteve të cilat tejkalojnë kushtet urbanistike, të pranishmet kanë folur për hapësirën publike më së shumti të shfrytëzueshme nga ana e tyre, Shadërvanin. Ato kanë deklaruar se me urgjencë duhet të shqyrtohen lejet e dhëna për qarkullim në Shadërvan. Numri i madh i automjeteve të cilat qarkullojnë në Shadërvan përgjatë intervaleve të ndryshme kohore brenda ditës, paraqet një rrezik shumë të madh për qarkullim sidomos për fëmijët. Përveç tjerash, dominimi i automjeteve e ka degraduar mundësinë e shfrytëzimit të kësaj hapësire për aktivitete të ndryshme apo thjesht

për shfrytëzim ditor. Pjesëmarrëset kanë kërkuar që të lejohen hyrja e vetëm një automjeti për një biznes, dhe atë në orët e hershme të mëngjesit.

### 2.3. Identifikimi i problemeve dhe kërkesave për realizim në lokacionet e përgjedhura

Ndër rrezultatet më konkrete të punëtorisë ka rezultuar të jetë puna në tri faza, në të cilat për tri lokacionet e përgjedhura në veçanti është bërë shqyrtimi i problematikave kryesore lidhur me diferencimin gjinor dhe sigurinë në shfrytëzimin e tyre. Nga faza e fundit, ajo e propozimeve për rimendësimin e këtyre hapësirave, janë listuar kërkesat konkrete të pjesëmarrëseve, anëtarëve të grupeve përkatëse.

Vlen të ceket se secili lokacion i përgjedhur ka rezultuar të jetë karakteristik për arsyet e veçanta. Në këtë mënyrë lokacioni nr.1, Kalaja dhe rrugët që të dërgojnë

<i><b>LOKACIONI NR.1: Kalaja dhe rrugët që të dërgojnë në Kala (ajo turistike dhe malore)</b></i>	
<b>PROBLEMET</b>	<b>KËRKESAT</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Prania a qenve endacak</li> <li>• Mungesa e ulëseve</li> <li>• Ulëset ekzistuese të pa mbështetëse</li> <li>• Papastërtia, rrugët nuk lahen në bazë të rregullt</li> <li>• Mungesa e ujit të pijshëm – kalimtarët duhet të blejnë ujë</li> <li>• Mungesa e ndriçimit (sidomos në rrugën turistike)</li> <li>• Shportat e mbeturinave jashtë funksionit</li> <li>• Mungesë e shërbimeve publike</li> <li>• Ngacmimi seksual</li> <li>• Dominimi i djemve dhe burrave</li> <li>• Rrezik shkuarje dhe qarkullimi</li> <li>• Limiti i shfrytëzimit deri në ora 18:00</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Vetëdijesim qytetar kundër ngacmimeve seksuale</li> <li>• Promovim i shfrytëzimit nga ana e vajzave, grave dhe nënave me fëmijë</li> <li>• Vendosja e kamerave për rritjen e sigurisë</li> <li>• Aplikim i dënimive mandatore kundër ngacmimeve dhe keqtrajtimit të hapësirave publike</li> <li>• Qarkullim i ‘policëve social’ për siguri më të madhe</li> <li>• Vendosja e toaleteve publike</li> <li>• Kontrolli i papastërtisë</li> </ul>

*Tabela 5. Identifikimi i problemeve dhe kërkesave për lokacionin nr.1*

në kala del të jetë më shumë potencial për shfrytëzim nga gratë dhe vajzat, por që siguria në lëvizje paraqet një limit të madh. Lokacioni nr.2, tek Zona Industriale nxit kurreshqen për rimendësimin e lidhjes jo-formale të krijuar nga vet qytetarët, me qëllim të krijimit të një hapësirë mirë të dizajnuar e cila do të rriste sigurinë në lëvizje. Ndërsa lokacioni nr.3, hapësira publike përreth Palestrës Sportive paraqet një potencial të madh, sidomos për banorët e lagjes Bazhdarhane, në të cilën hapësirë me shumë pak intervenime do të mund të plotësoheshin kërkesat e listuara të pjesëmarrëseve.

***LOKACIONI NR.2: Zona Industriale dhe lidhje me Qendrë Historike / Hapësira përreth Stacionit të Autobusëve***

PROBLEMET	KËRKESAT
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Lidhja e Zonës industrial me Stacionin e Autobusëve dhe Qendrën Historike</li> <li>• Kalimi nëpër shinat e trenit</li> <li>• Qarkullim problematik gjatë ditës dhe natës</li> <li>• Mungesë e patrollimit të Policisë</li> <li>• Mungesë e ulëseve në stacion të autobusëve</li> <li>• Grupe të dyshimta individësh</li> <li>• Veprimtari jo ligjore te 'Shtrumfat'</li> <li>• Prostitucioni</li> <li>• Mbeturina – mungesë e shërbimeve të duhura publike</li> <li>• Mungesë e shportave përmbeturinave</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Diazjnim i një vendkalimi mbi shinat e trenit</li> <li>• Ndriçim publik</li> <li>• Të jetë e çasshme për PAK</li> <li>• Pastrimi i mbeturinave në baza ditore</li> <li>• Qendër informative për turistë</li> <li>• Ulëse (të përshtatshme për gra dhe vajza)</li> <li>• Patrollim i policisë dhe ndalim i aktiviteteve jo ligjore</li> <li>• Transporti publik i organizuar nga Komuna që kalon edhe nga Zona Industriale</li> <li>• Trotuare të përshtatshme edhe për lëvizje me karrocë</li> <li>• Aplikim i semaforëve</li> <li>• Aplikim i zebrave</li> <li>• Vetëdijesim i qytetarëve përgacimet seksuale</li> <li>• Kyqje nga Lagjja Arbana</li> <li>• Aplikim i trotuareve në Zonën Industriale</li> <li>• Limit i caktuar i shpejtësisë</li> <li>• Zgjidhje e problemit të lidhjes 'Prostitucion-Emergjencë'</li> </ul>

*Tabela 6. Identifikimi i problemeve dhe kërkesave për lokacionin nr.2*

*LOKACIONI NR.3: Hapësia Publike përreth Palestrës Sportive*

PROBLEMET	KËRKESAT
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Hapësirë gjelbëruese e pashfrytëzuar</li> <li>• Gjelbërim po, por i pa organizuar për shfrytëzim</li> <li>• Mungesë e ndriçimit publik dhe ulëseve</li> <li>• Vendosa e LUNA-Parkut</li> <li>• Pasiguria gjatë natës</li> <li>• Shfrytëzim i poligonit/ rrezik për këmbësorë</li> <li>• Kafiteri “burrash”</li> <li>• Fitnesi – i pa sigurt edhe gjatë ditës/ dominohet nga burrat</li> <li>• Luna Parku- e prish imazhin e hapësirë publike, nuk frekuentohet nga nënët me fëmijë por nga nxënësit e ardhur nga ekskurzionet</li> <li>• Lojrat e pasigurta dhe të pa pastërtë</li> <li>• Uzurpim i hapësirës publike</li> <li>• Shtegu për ecje deri në Palestrën Sportive i pa shfrytëzuar nga gratë</li> <li>• Fushëloja me dominim shfrytëzimi nga burrat</li> <li>• Shpejtësi e madhe e automjeteve</li> <li>• Tregu &amp; Lunaparku – kaos për banorët dhe kalimtarët</li> <li>• Ndikim jo i mirë për qerdhen ‘Ylli’ka’</li> <li>• Hapësira e tregut të lëndëve djegëse-problematike për lokacionin në tërësi</li> <li>• Ndalim parkimi i veturave në trotuare dhe përreth stacionit lokal të autobusëve</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Rimendësimi i hapësirës publike</li> <li>• Largimi i LUNA-Parkut</li> <li>• Ndriçimi i shtegut për ecje që lidh banorët me Palestrën Sportive</li> <li>• Kënd për lojëra të fëmijëve</li> <li>• Hëpësirë e dizajnuar për polygon dhe staza për rrollera</li> <li>• Toalete publike</li> <li>• Hapësirë për gjidhënje</li> <li>• Sport për gra dhe vajza</li> <li>• Largim i aktiviteteve private</li> <li>• Vendosje e policëve të shtrirë</li> <li>• Tregu i gjëlbërt në vend të tregut të lëndëve djegëse</li> <li>• Shteg për bicikleta</li> </ul>

*Tabela 7. Identifikimi i problemeve dhe kërkesave për lokacionin nr.3*

### 3.0 VIZIONIMI I KËRKESAVE TË PUNËTORISË

Bazuar në resultatet e pyetësorëve, resultatet e observimeve në terren dhe punës konkrete përgjatë tri fazave të punëtorisë (të shpalosura paraprakisht në raport), janë dhënë propozime konceptuale lidhur me rimendësimin e tri lokacioneve të cilat kanë qenë në fokus të punëtorisë "Gratë dhe haëspira publike - Siguria në hapësirat publike".

Ekipi i angazhuar për ideimin e punëtorisë dhe realizimin e vizionimeve, është angazhuar maksimalisht në përfshirjen e të gjitha kërkesave të parashtruara nga gratë pjesëmarrëse në fokus grupin dhe punëtorinë e mbajtur. Propozimet, edhe pse konceptuale, paraqesin produkt konkret të kësaj punëtorie, përmes së cilës synohet targetimi i insituacioneve përgjegjëse me qëllim të ofrimit të një vizionimi lidhur me mundësinë e rimendësimit të disa prej hapësirave publike në Prizren, në favor të shfrytëzimit të tyre nga ana e grave dhe vajzave.

#### 3.1. Lokacioni: Rrugët që të dërgojnë në Kala dhe Kalaja, përfshirë Kompleksin e Marashit

Pjesëmarrëset e punëtorisë kanë folur për dëshirën e tyre të madhe për të zhvilluar aktivitetin e tyre rekreues dhe sportiv përgjatë dy rrugëve që të dërgojnë në Kala. Fatkeqsisht, rezultatet e dalura nga anketimi dhe observimi direkt në këtë zonë, tregojnë për një realitet tjetër!




Fig. 9. Integrimi i rrjetit të ndriqimit të shtuar publik dhe kontrollës përmes kamerave në rrugët që të dërgojnë në Kala

Gratë nuk ndihen të sigurta që të vetme, apo edhe një shoqëri të grave të tjera të marrin rruge malore apo turistike për të shkuar në Kala. Ato rëndom shfrytëzojnë vetëm pjesën e poshtme e cila i takon Kompleksit të Marashit. Ndër kërkesat kryesore të tyre për ta përmirësuar këtë situatë ka qenë integrimi i ndriqimit të shtuar publik përgjatë gjithë trajektores që e përshkon Kalanë së bashku me kamerat monitoruese.



*Fig. 10. Vizionimi i hapësirave publike a.) Rruga turistike për në Kala,  
b.) Rruga malore për në Kala /Kompleksi i Marashit*

Gratë më të shtyera në moshë kanë vënë në pah nevojën për ri-dizajnimin e rrugës turistike që të dërgon në Kala, e cila sipas tyre do të duhej të ishte veç tjerash e mirëmbajtur, në mënyrë që ato të mund të ecin lirshëm pa shoqërues. Kërkesë e tyre ishte prania e ulëseve në intervale me të shpeshta.



*Fig. 10. Pikat e kontrollës në rrugën malore*

Ndërsa ndriqimi publik të dominonte përgjatë gjithë rrugës në mënyrë që ato të mund të qarkullonin edhe të vetme. Shportat e mbeturinave dhe pastërtia në nivel janë poashtu ndër kërkesat mandatore.

Pjesëmarrëset poashtu kanë kërkuar shqyrtimin e mundësisë së pranisë së Policëve Social me theks në hapësirat përreth Kalasë, marr parasysh numrin e madh të vandalizmave në këtë zonë. Në këtë mënyrë është përpiluar prpopizimi i pikave kontrolluese përgjatë rrugës malore në të cilat autoritet e caktuara për mbikqyrje do të mund të qëndronin për intervale të caktuara kohore, gjë që do të rriste ndjenjën e sigurisë për kalimtarët e rastit.

### 3.2. Lokacioni: Zona Industriale dhe lidhja me Qendrën Historike, përfshirë hapësirën përreth Stacionit të Autobusëve

Diskutimet përgjatë punëtorisë kanë dëshmuar një nevojë të pakontestueshme të dizajnimit të një shtegu lidhës në mes të Zonës Industriale dhe Qendrës Historike. Observimet në këtë zonë tregojnë për një numër të madh të shfrytëzuesve të shtegut jo formal sidomos gjatë ditës. Mirëpo në mbrëmje intenzistë bie, duke e kthyer këtë zonë të pa sigrutë për kalim për gratë dhe vajzat. Në mënyrë që të qarkullojnë nga njëra pjesë, në tjetër pjesë të qytetit, ato duhet të shfrytëzojnë automjetet si mënyrë të vetme transporti. Poashtu mungon transporti publik i cili do të bënte lidhjen e Qendrës Historike me Zonën Industriale.

Pjesëmarrëset e punëtorisë kanë folur poashtu për shqetësimet e tyre lidhur me përbajtjet e dyshimta në këtë zonë, me theks në kafenetë në të cilat ushtrohet edhe prostitucioni. Këto aktivitete të dyshimta e ngrisin nivelin e pasigurisë në një zonë e cila në të kundërtën do të duhet të ishte një hapësirë e promovimit të vlerave turistike dhe kulturore, marrë parasysh qarkullimin e turistëve përmes Stacionit të Autobusëve. E tërë hapësira publike përreth Stacionit të Autobusëve është tërësisht e pa trajtuar, duke patur potencial për krijimin e një hapësire shumë të madhe gjelëbruese dhe për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme atraktive për banorët e rrëthinës dhe turistët potencial.





Fig. 11. Skema funksionale e sheshit të propozuar

Shtegu i propozuar si rezultat i punëtorisë konsiston në krijimin e një sheshi të dizajnuar në mes të pjesës lindore dhe jugore të indit urban, dha asaj perëndimore të njojur si Zona Industriale.

Kjo hapësirë publike do të ishte epiqendër e lidhjes funksionale të shumë përbajtjeve përreth, përfshirë: Stacionin e Autobusëve, Zonën Industriale në njérën anë, Qendrën Historike në anën tjetër.



*Fig. 12. Përbajtjet funksionale në sheshin e propozuar*



*Fig. 12. Vizuelizimi i hapësirës në afërsi të ish-Stacionit të Trenit / shfrytëzimi i shinave të trenit për këjimin e hapësirave gjelbëruese dhe atraktive*

Ky shesh do të krijontë mundësinë e zhvillimit të përbajtjeve të reja funksionale që do të zëvendësosnin aktivitetet e grupacioneve të dyshimta në këtë zonë. Parqet dhe aktivitetet sociale do të mund të rrisnin interesimin e kalimtarëve për ta shfrytëzuar këtë hapësirë publike, duke e bërë atë më aktive dhe më të sigurtë për shfrytëzim nga ana e grave dhe vajzave. Inkuadrimi i një pike informuese për turistët në afërsi të Staconit të Autobusëve do të mund të rriste kredibilitetin e kësaj hapësirë dhe të ndikonte direkt në përshtypjen e parë të turistëve për Prizrenin në përgjithsi. Integrimi i hapësirave për ulje, ndriqimit dhe gjelbërimit të shtuar do tu shërbente për të mirë të gjitha grueve të komunitetit Prania e transportit publik në të dy polet e sheshit të ri do të krijontë lidhje më të mira në shërbim të qytetarëve.

### 3.3. Lokacioni: Hapësira publike përreth Palestrës Sportive

Hapësira publike përreth Palestrës Sportive është rasti i tretë i diskutuar përgjatë punëtorisë "Gratë dhe hapësira publike - Siguria në Hapësirat Publike". Kjo hapësirë për dallim nga dy rastet e para, posedon infrastrukturë më të mirë dhe do të mund të ishte më leht e adaptueshme në kërkesat e parashtruara nga ana e pjesëmarrëseve të punëtosirë.

Edhe pse aktivistet e pranishme në Fokus Grupin e organizuar para mbajtjes së punëtoris, kanë përzgjedhur për diskutim vetëm hapësirën publike para Palestrës Sportive, gratë dhe vajzat e pranishme në punëtori e kanë zgjeruar këtë rast të studimit duke përfshirë këtu edhe hapësirat tjera publike në afërsi. Për secilën hapësirë publike janë propozuar përbajtje të reja funksionale të cilat do të ndikonin në rimendësimin e tërë hapësirës përreth Palestrës Sportive, me fokus në shfrytëzimin e saj më të madh nga ana e grave dhe vajzave.




Fig. 13. Përbajtjet funksionale në hapësirën publike përreth Palestrës Sportive: A. Tregu i Gjelbërt dhe Parku i Integruar për banorët e objekteve në afërsi, B. Hapësira Sportive për gratë dhe vajzat, C. Hapësira Rekreuese për të gjitha grupmoshat, D. Park për fëmijë



*Fig. 14. Vizuelizimi i hapësirës publike në afërsi të Palestrës Sportive -  
Aplikimi i ushtrimeve fizike në ambient të hapur*

Kështu në hapësirën publike e cila momentalisht shfrytëzohet si treg i lëndëve djegëse (A), është propozuar që të integrohet tregu i gjelbërt me mundësi të aplikimit të dizajnit të përshtatshëm urban i cili do të mund të shërbente edhe si park për banorët e objekteve shumëbanesore në afërsi. Kjo zgjidhje do t'i largonte përmbajtjet e dëmshme për qytetarët në përgjithsi dhe për fëmijët, shfrytëzues të Qerdhes "Yllka" në veçanti.

Hapësira që tashmë dominohet nga burrat, do të mund të rimendësohej në favor të të gjithë qytetarëve, n.q.s do të krijuhet hapësira të përshtatshme për të gjithë. Dizajnimi i hapësirave sportive edhe për gratë dhe vajzat (B), do të mund të ndryshonte një realitet dominant të momentit, që vetëm burrat mund ta shfrytëzojnë hapësirën sportive përreth Palestrës Sportive dhe vetë objektin e Palestrës Sportive.

Prania e lojërave të menaxhuara nga personat e tretë në të ashtuquajturin 'Luna Park', ka dalë të jetë shumë shqetësues për pjesëmarrëset e punëtorisë. Ne vend të aktiviteteve private, gratë kanë propozuar që në këtë hapësirë të integrohen parqe për fëmijë dhe hapësira rekreative për të gjitha grupmoshat (C,D), të cilat do të mund të shfrytëzoheshin nga familjarët, banues të lagjeve në afërsi dhe nga të tjerët që vijnë posaqërisht për t'i shfrytëzuar këto hapësira nga pjesët e tjera të qytetit.

Për të gjithë hapësirën e rimendësuar, gratë kanë kërkuar ndriqim të shtuar publik dhe praninë e vazhdueshme të autoriteteve policore, Politit Social, në mënyrë që kjo hapësirë të jetë e sigurt për shfrytëzim nga të gjithë.

## 4.0 REKOMANDIMET

Bazuar në rezultatet e punëtorisë, rekomandohet:

- Të gjitha grupet e komunitetit të përfshihen në proces të planifikimit, me theks në grupet e marginalizuara ku bëjën pjesë edhe gratë. Promovimi i pjesëmarrjes së grave dhe vajzave në fazat e para të proceseve të planifikimit do të ndihmonte në përfshirjen direkte të kërkesave të tyre. Inkurajimi i përfshirjes së tyre në debatet publike është më se i domosdoshëm me qëllim të vënjes në pah të nevojave dhe kërkesave të tyre në raport me qytetin.
- Problemet në qështje urbanistike të shqyrtohen paralelisht me komponenten sociale, në mënyrë që të mund të jenë të pranueshme për të gjithë qytetarët, e në veçanti për gratë dhe vajzat.
- Autoritetet e sigurisë dhe rendit në nivel komunal të aktivizohen më shumë për qështjen e sigurisë së grave dhe vajzave në hapësirat publike në Prizren. Monitorimi i ngacmimeve, grupeve të dyshimta dhe të gjitha aktiviteteve të tjera jo ligjore, do të rrisnin sigurinë e këtij grupi të marginalizuar.
- Aplikimi i fushatave të ndryshme vetëdijësuese kundër ngacmimeve të vazhdueshme në hapësira publike ndaj grave dhe vajzave, do të ndikonte në përmirsimin e raportit të tyre me qytetin, duke krijuar ndjesinë e lëvizjes së lirë dhe qëndrimit të pa kusht në hapësirat që u takojnë të gjithëve.
- Përmirsimi i elementeve të caktuara të infrastrukturës së hapësirave publike, me theks të veçant në ndriqimin publik, do të përmirsonte kualitetin e hapësirave publike në Prizren, me theks në shfrytëzim të tyre nga të gjithë qytetarët.
- Përfshirja e elementeve të reja përbajtësore në hapësira të caktuara publike, do të mund t'i kthente ato në hapësira më shumë të frekuentuara dhe më miqsore për grupet e marginalizuara.

## **4.0 SHTOJCAT**

**5.1. Pyetesori**


**5.2. Hapësirat Publike në Prizren**

**5.3. Lokacionet e përzgjedhura për diskutim**

**5.4. Vizionimi i Lokacionit 1: Rrugët që të dërgojnë në Kala dhe Kalaja, përfshirë Kompleksin e Marashit**

**5.5. Vizionimi i Lokacionit 2: Zona Industriale dhe lidhja me Qendrën Historike, përfshirë hapësirën përreth Stacionit të Autobusëve**

**5.6. Vizionimi i Lokacionit 3: Hapësira publike përreth Qendrës Sportive**



EMRI (OPSIONALE):

MOSHA:

PROFESIONI:


1. A ndjeheni e sigurtë në hapësira publike?
  - a. Po
  - b. Jo
  - c. Pjesërisht
2. Nëse jo, cilat nga arsyet e mëposhtme ndikojnë në pasigurinë tënde?
  - a. Mungesa e ndriçimit publik
  - b. Prania e qenve endacak
  - c. Prania e grupeve të dyshimta
  - d. Menaxhimi jo i mirë i hapësirave publike
  - e. Ngacmimi nga burrat
  - f. Kanosja nga pakujdesia në trafik
  - d. Tjetër (listo arsyet tjetra)

---

---

3. Cilat nga hapësirat e mëposhtme i shfrytëzoni më shumë dhe në cilin interval kohorë?
  - a. Shadërvani \_\_\_\_\_
  - b. Kompleksi I Marashit \_\_\_\_\_
  - c. Sheshi i Lidhjes \_\_\_\_\_
  - d. Keji – segmenti te Ura Arasta \_\_\_\_\_
  - e. Keji – segmenti te Beledija \_\_\_\_\_
  - f. Hapësira publike te Palestra Sportive \_\_\_\_\_
  - g. Rruga Remzi Ademi \_\_\_\_\_
  - h. Hapësira publike në lagjen Ortakoll \_\_\_\_\_
  - i. Hapësira publike në lagjen Bazhdarhane \_\_\_\_\_
  - j. Shëtitorja për në Kala (rruga malore) \_\_\_\_\_
  - k. Kalaja \_\_\_\_\_
  - l. Parku i qytetit \_\_\_\_\_
  - m. Tregu i gjelbërt \_\_\_\_\_
  - n. Hapësira publike te stacioni i autobusëve \_\_\_\_\_
4. Cili aktivitet e përcjell shfrytëzimin tënd të hapësirës publike?
  - a. Kalimi i kohës së lirë
  - b. Ecja dhe vrapimi
  - c. Ushtrimet fizike
  - d. Dalja në pauzën e drekës
  - e. Leximi
  - f. Shoqërimi i familjarëve (prindërve, fëmijëve etj)

- g. Vrapimi
  - h. Socializimi me të tjerë
  - i. Shoqërimi i kafshëve shtëpijake
  - j. Pirja e kafes në ndonjë lokal afër
5. Sipas vlerësimit tuaj të përgjithshëm, a kanë infrastrukturënë shërbime të duhura publike hapësirat publike në Prizren?
- a. Ndriçim publik
  - b. Hapësira për ulje
  - c. Hapësira gjelbëruese
  - d. Toalete
  - e. Ujë
  - f. Parqe për fëmijë
  - g. Patrolla të Policisë
  - h. Shërbime të duhura komunale
6. A mendoni se hapësirat publike në Prizren janë të dominuara nga burrat?
- a. Po
  - b. Jo
7. Nëse po, a ju limiton ky fakt në shfrytëzimin e hapësirës publike?
- a. Po
  - b. Jo
8. A jeni ngacmuar ndonjëherë gjatë shfrytëzimit të hapësirës publike (përfshirë komentet jo të dëshirueshme gjatë qëndrimit apo ecjes)?
- a. Po
  - b. Jo
9. Nëse po, a e keni raportuar ndonjëherë këtë në organet e rendit?
- a. Po
  - b. Jo
10. Bazuar në situatën aktuale, a është hapësira publike në Prizren vend i mundshëm për gjidhjenje?
- a. Po
  - b. Jo
11. Cilat nga elementet e mëposhtme do të përmirësonin shfrytëzimin e hapësirave publike në Prizren?
- a. Siguri më e madhe në lëvizje dhe qëndrim
  - b. Aktivitete të ndryshme kulturore
  - c. Aktivitete të ndryshme sportive
  - d. Aktivitete për fëmijë
  - e. Infrastrukturë më e mirë publike
  - f. Shërbime më të mira komunale




5.2 HAPËSIRAT PUBLIKE NË PRIZREN



### 5.3 LOKACIONET E PËRZGJEDHURA PËR DISKUTIM



5.4 VIZIONIMI I LOKACTIONIT NR.1 - KALAJA DHE RRUGËT QË TË DËRGOJNË NË KALA/ PËRFSHIRË KOMPLEKSIN E MARASHIT




5.4 VIZIONIMI I LOKACTIONIT NR.1 - KALAJA DHE RRUGËT QË TË DËRGOJNË NË KALA/ PËRFSHIRË KOMPLEKSIN E MARASHIT







5.4 VIZIONIMI I LOKACTIONIT NR.1 - KALAJA DHE RRUGËT QË TË DËRGOJNË NË KALA/ PËRFSHIRË KOMPLEKSIN E MARASHIT



5.4 VIZIONIMI I LOKACIONIT NR.1 - KALAJA DHE RRUGËT QË TË DËRGOJNË NË KALA/ PËRFSHIRË  
KOMPLEKSIN E MARASHIT



5.5 VIZIONIMI I LOKACTIONIT NR.2 - ZONA INDUSTRIALE DHE LIDHJA ME QENDRËN HISTORIKE,  
PËRFSHIRË HAPËSIRËN PËRRETH STACIONIT TË AUTOBUSËVE



5.5 VIZIONIMI I LOKACIONIT NR.2 - ZONA INDUSTRIALE DHE LIDHJA ME QENDRËN HISTORIKE,  
PËRFSHIRË HAPËSIRËN PËRRETH STACIONIT TË AUTOBUSËVE



5.5 VIZIONIMI I LOKACTIONIT NR.2 - ZONA INDUSTRIALE DHE LIDHJA ME QENDRËN HISTORIKE,  
PËRFSHIRË HAPËSIRËN PËRRETH STACIONIT TË AUTOBUSËVE



5.5 VIZIONIMI I LOKACTIONIT NR.2 - ZONA INDUSTRIALE DHE LIDHJA ME QENDRËN HISTORIKE,  
PËRFSHIRË HAPËSIRËN PËRRETH STACIONIT TË AUTOBUSËVE



5.5 VIZIONIMI I LOKACIONIT NR.3 - HAPËSIRA PUBLIKE PËRRETH QENDRËS SPORTIVE



5.5 VIZIONIMI I LOKACTIONIT NR.3 - HAPËSIRA PUBLIKE PËRRETH QENDRËS SPORTIVE



5.5 VIZIONIMI I LOKACTIONIT NR.3 - HAPËSIRA PUBLIKE PËRRETH QENDRËS SPORTIVE